



Pranuar / Dorezuar Prenheno/Prilato Received/Delivroy	08 - 11 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohema Quantity
SKIMSHAK	6890/2022		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.825/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.825/2022 të datës 26.09.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Komuna e Vitisë, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.11.2022, mori këtë:

### V E N D I M

**I. APROVOHET** si e bazuar ankesa A.nr.825/2022 e datës 26.09.2022, e parashtruar nga ankuesi

**II. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Vitisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të ndërmerr veprimet administrative konformë përgjegjësiive ligjore me qëllim që paga e ankuesit të jetë sipas koeficientit tetë pikë pesë(8.5).

**III. DETYROHET** Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të nxjerrë akt administrativë përkatësisht ankuesit ti lëshoj aktemërimin me koeficientë tetë pikë pesë(8.5).

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

## A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Komunën e Vitisë, në pozitë "Udhëheqës i Zyrës së Regjistrimit Civil", sipas Akt emërimit nr. Protokolli 03-112/2363 të datës 30.12.2011 me koeficient tetë (8).

Me datën 10.08.2022 fillimisht ka parashtruar kërkesën me numër 02-070/01-33892 drejtuar Kryetarit të Komunës së Vitisë, Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, lidhur me kompensimin material sipas koeficientit tetë (8.0), sepse i njëjti pagën e merr sipas koeficientit 7.5 .

Pasi që nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën e tij të datës 15.08.2022, me datë 26.09.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagës respektivisht diferencën e koeficientit nga 7.5 në 8.0 sipas Akt emërimit nr. Protokolli 03-112/2363 të datës 30.12.2011, nga se sipas ankuesit zyrtarët e të njëjtës kategori janë duke u paguar me koeficient tetë, poashtu ankuesi thekson faktin se sipas shkresës së DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 pozita të cilën e ushtroj duhet të paguhet sipas koeficientit 8.5.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 30.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Vitisë, ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 10.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Vitisë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/10.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 5660/2022 të datës 26.09.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; kërkesë e datës 15.08.2022 me numër 02-070/01-33892 drejtuar Kryetarit të Komunës së Vitisë, Drejtorit të Drejtorisë së Financave dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore; Akt emërimi Nr. Protokolli 03-112/2363 të datës 30.12.2011; Konkursi i datës 21.07.2021; Akt emërimi në emër XH.V, AE.Nr.48/2021, datë 02/09/2021, Akt emërimi në emër të A.H ,Nr. Protokolli 03-112/999 i datës 03.12.2013; Akt emërimi në emër të I.J ,Nr. Protokolli 02-112/1002 të datës 03.12.2013; Akt emërimi në emër të H.A, Nr. Protokolli 07-112/2389 i datës 30.12.2011; Akt emërimi në emër të N.A, Nr. Protokolli 06-112/2484 i datës 30.12.2011; Konkurs i datës 01.12.2021; Konkurs i datës 19.05.2021; Konkurs i datës 22.03.2022; Lista e nëpunësve prej 1/5 faqe; Përgjigjen në ankesë e datës 10.10.2022, 1/10 nga Komuna e Vitisë, Përgjigje në Ankesë e datës 01.02.2018 drejtuar KPMSHCK-së, nga Udhëheqësi i Personelit/Viti; Ankesë e datës 22.01.2018 drejtuar KPMSHCK-së, nga ankuesi; Vendimi i datë 29.05.2019 me Nr.P.02-320/04-24783; Ankesë e datës 24.05.2019 për Komisionin e ankesave në Komunë të Vitisë; Ankesë e datës 10.06.2019 për KPMSHCK; Përgjigje e datës 24.06.2019 për KPMSHCK nga NJBJ në Viti; Lista e pagave e muajit Qershor 2022, bashkangjitur dhe përgjigje ne forme elektronike e datës 12.10.2022 me provat e njëjta të administruara si më lartë, E-maili i datës 01/11/2022 bashkangjitur vendimin e KPMSHCK-së, A.nr.795/2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit Nr. Protokolli 03-112/2363 të datës 30.12.2011 mbanë pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Regjistrimit Civil" me koeficient tetë (8) ndërsa i njëjti aktualisht është duke u kompensuar sipas koeficientit shtatë pikë pesë (7.5).

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave* si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: *1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara më këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Vitisë ka aplikuar koeficient të ndryshëm lidhur me pozitat e udhëheqëseve të sektorëve brenda këtij institucioni si pozita të kategorisë së njëjtë të punës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale të siguruara nga ana e ankuesit, ka konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit me numër protokolli 03-112/2363 të datës 30.12.2011 mbanë pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Regjistrimit Civil", dhe i njëjti është duke u kompensuar me koeficientin shtatë pikë pesë (7.5), kurse sipas aktemërimit ka koeficientin tetë(8),ndërsa kolegji vëren se pozitat e njëjta me pozitën që mbanë ankuesi kanë koeficient të ndryshëm të cilat u argumentuan nga ankuesi me shkresa dhe at si më poshtë: Përgjegjësi i Zyrës Ligjore e ka koeficient 8 të pagës, Udhëheqësi i Zhvillimit Ekonomik, sipas Akt emërimit me numër 06-112/2484 të datës 30.12.2011, ka koeficient 8 të pagës, Përgjegjës i Sektorit për Buxhet dhe Financa sipas Akt emërimit me numër 02-112/1002 të datës 30.12.2013, e ka koeficient 8 të pagës, Përgjegjës i Sektorit për Pronë sipas Akt emërimit me numër 02-112/2389 të datës 30.12.2011, e ka koeficientin 8 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda të njëjtit institucion dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 2 ku përcaktohet se: *Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, ...të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:..... 3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës;* si dhe nenin 4 paragrafi 1 të të njëjtit ligj ku thuhet se: *"Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.*

Kolegji me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes bazuar edhe në pretendimin ankimor të cilit ju ka referuar ankuesi me rastin e ankesës mori për bazë edhe shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit



të Shërbimit Civil/MAP,e cila shkresë zyrtare është adresuar për Sekretarët e Përgjithshëm, Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe Menaxherët e Personelit të institucioneve publike përmes të cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitive përkatëse, rrjedhimisht për pozitën Udhëheqës i Sektorit është vendosur koeficienti tetë pikë pesë (8.5). Ndërlidhur me pretendimin ankimor të ankuesit, i cili me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka kërkuar diferencën dhe harmonizimin e koeficientit nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë (8), Kolegji ka konstatuar se bazuar në shkresën e lart cekur për pozitën e ankuesit parashihet koeficienti tetë pikë pesë (8.5) e jo siç është duke u kompensuar me koeficientin shtatë pikë pesë (7.5) përkundër që ka aktemërimin me koeficientin tetë (8), andaj duke marrë për bazë këto arsye kolegji konstaton se ankuesit bazuar në legjislacionin në fuqi të Shërbimit Civil i takon koeficienti tetë pikë pesë (8.5), dhe mbi këtë bazë ligjore është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, bazuar si më lartë, Kolegji konstaton se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Vitisë me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañsisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Kryetari i Komunës së Vitisë dhe Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Vitisë, me faktin e mos përgjigjes në kërkesën e datës 15.08.2022 të adresuar nga ankuesi, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe rrjedhimisht nuk kanë zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe akteve nënligjore që rregullojnë këtë çështje, dhe për këtë arsye me qenë se ekziston baza ligjore e kërkesës si dhe bazuar në parimin e efikasitetit të procedurës administrative, këshilli vendosi meritorisht në lidhje me këtë ankesë, duke obliguar Kryetarin e Komunës së Vitisë dhe Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë që të ndërmarrin veprimet konformë dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.825/2022, datë 08/11/2022.

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.